



Klubi Zvicerian ne Shqiperi

Schweizerklub Albanien

Club Suisse Albanie



Statuti i klubit Zvicerian

1. Qellimi

- 1.1. Te zhvilloje me tej lidhjet e miqesise dhe bashkjetesen ndermjet individeve, gjera te cilat hyjne ne objektivat kryesore te shoqerise zviceriane. Ajo eshte politikisht dhe rreptesisht neutrale.
- 1.2. Shoqeria mbron interesat e zvicerianeve ne Shqiperi dhe maredheniet e tyre me atdheun. Ajo bashkepunon me Ambasaden Zviceriane ne Shqiperi dhe me organizatat e zvicerianeve jashte shtetit me qender ne Bern.
- 1.3. Shoqeria mund te kujdeset per zvicerianet ose per familjet e anetareve te se ciles kane rene ne krye te detyres ne Shqiperi.

2. Titujt e anetareve

- 2.1. Te gjitha zvicerinet te rregjistruar ne Ambasaden Zviceriane ne Tirane mund te behen anetare te shoqerise. Te rekomanduar nga komiteti i te huajve duke patur nje lidhje me Zvicren mund te behen anetare pas pranimit me ane te votes nga Asambleja e Pergjithshme. Anetaret duhet t'i kene kaluar te 18 vjetet.
- 2.2. Asambleja e Pergjithshme mund te zgjedhe si anetare nderi persona qe kane merita te vecanta kundrejt Klubit.

3. Pranimi, largimi, perjashtimi

- 3.1. Kerkesat per pranimin e qytetareve zviceriane adresohen ne sekretarine e Shoqerise. Komiteti vendos per pranimin e disa personave dhe informon Asamblene e pergjithshme.
- 3.2. Anetaret qe deshirojne te largohen nga shoqeria duhet te informojne sekretariatin.
- 3.3. Komiteti rezervon heqjen nga lista te ndonje anetari i cili nuk permbush detyrimet e tij ose qe manifeston nje sjellje demtuese kundrejt Klubit. Masat e mara nga Klubi kundrejt te te perjashtuarit hyjne ne fuqi menjehere.

4. Organizimi

- 4.1. Shoqeria drejtohet nga nje komitet i cili perbehet nga:
Presidenti
Zevenedspresidenti
Sekretarja
Arketari
Ndihmes
Presidenti dhe shumica e anetareve te komitetit duhet te jene me kombesi zviceriane.
- 4.2. Dy njerez qe verifikojne llogarite ia raportojne ato Asamblese se Pergjithshme, e cila shkarkon arketarin.

- 4.3. Vota e komitetit dhe e verifikuesve të llogarise kryhet me ngritje dore në qofte se nuk kërkohet votimi sekret nga të paktën 5 anëtarë.
- 4.4. Anëtarët e komitetit emerohen çdo vit dhe mund të rizgjidhen. Në rastet largimi të parakohshëm të ndonjë anëtari të komitetit, një zëvendësues mund të zgjidhet nga komiteti, i cili duhet të jetë i konfirmuar me pare nga Asambleja e Përgjithshme.
- 4.5. Komiteti i trajton punët gjatë dhe vendos me anë të mazhorancës. Në rast se votat janë të barabarta, ai që vendos është presidenti.
- 4.6. Të paktën 4 anëtarë të komitetit duhet të jenë prezent që të mund të merret një vendim.
- 4.7. Për punët financiare firma e presidentit përveç asaj të ndonjë anëtari tjetër të komitetit është e nevojshme.

5. Kuota

- 5.1. Asambleja e Përgjithshme vendos shumën e kuotës vjetore.

6. Asambletë

- 6.1. Asambleja e Përgjithshme e zakonshme mbledhet një herë në vit para 2 prillit. Komiteti mbledh anëtarët dhe i njeh ata me rregullin e ditës të paktën dhjetë ditë përpara.
- 6.2. Asambleja e Përgjithshme ngarkon komitetin për drejtimin e një viti referencë.
- 6.3. Kërkesat për modifikimin e statutit dhe kërkesat për dorëheqje nga ana e anëtarëve të komitetit janë parashtruar të paktën 5 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të zakonshme.
- 6.4. Komiteti mund të kërkojë mbajtjen e një Asambleje të Përgjithshme të jashtëzakonshme. Ajo thërret anëtarët dhe i njeh ata me urdherin e ditës të paktën dhjetë ditë përpara. Një Asamble e Përgjithshme e jashtëzakonshme duhet të mbledhet n.q.s.e të paktën një e treta e anëtarëve shprehësh dëshirën me anë të të shkruajturit. Ajo duhet të mbledhet 30 ditë me vonë kërkesës me shkrim të paraqitur nga anëtarët..
- 6.5. Asambleja e Përgjithshme nuk mund të shqyrtojë në mënyrë të vlefshme më pak se 10 vota.
- 6.6. Vendimet merren me anë të mazhorancës. Në rast se votat janë të barabarta është presidenti ai që vendos.
- 6.7. Çdo anëtar i shoqërisë ka të drejtën e votës në kohën e Asamblesë së Përgjithshme me përjashtimet e mëposhtme:
I Duke miratuar lidhjet e zvicerianëve larg atdheut të tyre, vetëm me kombesin zvicerianë kanë të drejtë vote. Kjo është e vlefshme gjithashtu edhe për modifikimet e statuteve që duhet të votohen nga të paktën 50% e anëtarëve nga mazhoriteti absolut.

7. Shpërberja

- 7.1. Shpërberja e shoqërisë mund të vendoset vetëm nga Asambleja e Përgjithshme duke mbledhur të paktën 2/3 e anëtarëve, nga vota mazhoritare e 3/4 të zerave.
- 7.2. Në rast shpërberjeje fondet e Klubit i shkojnë Ambasadës Zviceriane në Tiranë, e cila pas dy vjetësh i shpërndan ato në shenjë bamiresie.

Forma e gjinisë mashkullore e përdorur në këto statute vlen gjithashtu edhe për personat e gjinisë femërore.